

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 622-24-4513-5-1-1/C1472

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

RENELUAL TAHIRI SH.P.K., Joni 92/2, PRIZREN, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Gjonaj me numër identifikues: 622-24-4513-5-1-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Gjonaj**

No.	Lot
1	Ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Gjonaj

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **1,659,389.50 €** (një million e gjashtëqind e pesëdhjetë e nënt mijë e treqind e tetëdhjetë e nënt euro e pesëdhjetë cent).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
(Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)

[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.


Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Iasa Osmankaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	23.08.2024
Vula:	

[Ne rast të kontratave me vlerë të madhe]

Emri:	Z. Shaqir Totaj Kryetar
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	26.08.24
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Yll Hoxha
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	26/08/24
Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 622-24-4513-5-1-1/C1472

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 25 muaj kalendarik .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 03 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit .

Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë .dy dit pas hyrjes në fuqi të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 700 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të kontratës
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës do të jetë: Çelë Lamaj Drejtor në DSHP Menaxheri i Kontratës është: Alban Krasniqi IDN në DSHP
Parapagimi		Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: e vlerës se kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 2 vite kalendarike pas pranimit përfundimtar të punimeve.
Pagesa shkëputjes pas së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shumat e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Neni 42 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK. 43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, Remzi Ademaj, -20000, PRIZREN,

Zyrtari përgjegjës i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 622-24-4513-5-1-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **RENELUAL TAHIRI SH.P.K., Joni 92/2, 20000, PRIZREN, Kosovë**

E-mail: **renelual_tahiri@hotmail.com**

Personi kontaktues: **Yll Hoxha**

Telefoni: **044/128112**

Faxi:

Numri fiskal: **810610099**

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 622-24-4513-5-1-1

Titulli i kontratës: Ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Gjonaj

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Ndërtimi i infrastrukturës në fshatin Gjonaj

3. Çmimi total i tenderit është:

1,659,389.50 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 120 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Thëksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR NDËRTIMIN I TROTUARËVE DHE MUREVE MBROJTËSE					
1	TROTUARËT ; B=2.00m , L=1445m				
Nr.	PUNIME PARAPREGADITORE	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithësej (€)
1.1	Mobilizimi dhe rregullimi i punishteve për punë si dhe largimi i instalimeve në punishte në rast se ka në ato hapësira.	m'	1445.00	0.50	722.50 €
1.2	Shenimi i trasesë si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit.	m'	1445.00	1.00	1,445.00 €
1.3	Pastrimi i trasesë së rrugës nga të gjitha materialet që pengojnë pregaditjen e plenumit. Në qmim të kalkulohen të gjitha materialet e panevojshme komplet për gjatësinë e rrugëve.	m'	1445.00	0.50	722.50 €
Gjithësej 1.0:					2,890.00 €
2.0	PUNIMET E DHEUT				
2.1	Germimi i tamponit t=10 cm me mundësi që i njëjti prap të perdoret.	m³	361.25	5.00	1,806.25 €
2.2	Gërmimi i dheut me makineri të kategorisë së IV-V të me ngarkim dhe bartje deri në deponi (dëmi në 15Km). Sasia të llogaritet në gjendje natyrore.	m³	2167.50	5.00	10,837.50 €
2.3	Formësimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës me ngjeshmeri 30 MN/m².	m²	2890.00	0.50	1,445.00 €
Gjithësej 2.0:					14,088.75 €
3.0	MBISTRUKTURA				
3.1	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës stabilizuese me material mbushës jo koherent nga guri gëlqeror CBR>20% që i plotëson kushtet dhe kriteret e parapara për stabilizim të pjesëve anësore dhe plotësim të trasesë së rrugës. Ngjeshet në shtresë me trashësi të shtresës t=25 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes (Module dinamike me pllake rrethore) E _{vd} =60 MN/m². Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.	m³	903.13	15.00	13,546.88 €
3.2	Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së rrugës , nga materiali guror ,Fraksion (0 deri 31.50) mm me trashësi të shtresës t=15 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes (Module dinamike me pllake rrethore) E _{vd} =70 MN/m² . Materiali i përdorur duhet të jetë i paisur me ateste paraprake ,dhe atë sipas normave dhe standardeve.Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.	m³	541.88	15.00	8,128.13 €
3.3	Furnizimi , transporti dhe vendosja e skajoreve në bazament betoni , C-35/37.				- €
	me dim.10x20x100cm	m'	1445.00	10.00	14,450.00 €
	me dim.15x24x100cm	m'	1445.00	15.00	21,675.00 €
3.4	Sigurimi , me pahi mbrojtëse ,punimi dhe perforcimi i skajorit duke krijuar shputë beton arme ku ndërtohet trotuari përreth kanalit atmosferik të hapur , me qëllim që mos shembet .Punimet kryhen sipas gjendjes ekzistuese në teren duke i rrespektuar , normat dhe standardet. Llog në komplet gjatësinë e trotuarit	komplet	1.00	1000.00	1,000.00 €

3.5	Furnizimi me material dhe punimi I bazamentit dhe mureve - coklla (h=0.5-1.0 m) mbrojtese nga BA duke parapare kallupimin dhe punimin e armaturës , te parashihet edhe gerrmimi I bazamentit te murit dhe largimi I dheut , në qmim kalkulohet edhe punët zhavorrike dhe drenazhuese deri ne finalizim te këtij pozicioni .Log m3	m³	32.00	150.00	4,800.00 €
3.6	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e kubzave te betoni t=8cm, C- 35/37 në shtres rëre frak. (4-8)mm me t=5cm dhe mbushja e fugave me rër, duke përfshir edhe zgjerimet dhe kyqjet ne rrugë.	m²	2890.00	15.00	43,350.00 €
3.7	Ngritja dhe nivelizimi i pusetave të kanalizimit ekzistues deri në nivelin e kubzave, si dhe furnizimi me kapk metalik 25t dhe montimi i tyre në bazament betoni. Log në copë .Vërtetje ky pozicion aplikohet vetëm në raste ku paraqitet nevoj e ngritjes pusetave.	copë	30.00	150.00	4,500.00 €
3.8	Rregullimi i trases dhe pastrimi i punishtes nga materialet ndertimore.	m'	1445.00	0.50	722.50 €
3.9	Punimi I kaleses-ures per kembesor mbi prrua me profile Celiku me dim. L=2.5 m,b=2 m , duke parapare edhe gardhin ne dy ane,ura duhet te inkastrohet ne muret BA ekzistuese .	kg	480.00	5.50	2,640.00 €
Gjithsejt 3.0:					114,812.50 €

REKAPITULLIMI I NDËRTIMIT TROTUARVE

1.0	PUNËT PARAPRAKE	Gjithsej 1.0:	2,890.00 €
2.0	PUNIMET E DHEUT	Gjithsej 2.0:	14,088.75 €
3.0	MBISTRUKTURA	Gjithsejt 3.0:	114,812.50 €
TOTALI ME TVSH:			131,791.25 €

REKAPITULLIMI TOTAL TROTUARI DHE MUREVE

1.0	PUNËT TROTUARIT DHE MUREVE	131,791.25 €
TOTALI ME TVSH:		131,791.25 €

KUBËZIMI I RRUGËVE DHE INFRASTUKURËS PËRÇJELLËSE NË FSHATIN GJONAJ

2. KUBËZIMI I RRUGËVE A=3000 m². Akasi 1 L=71.93 , B=4 m ; Aksi 2 dhe 3 L=396.67m ,B=4m ; Aksi 4 L=39.44 , B= 4m ; Aksi 5= 40m b=4m ; Aksi 6 L=80.51 m ,b=4m ; Aksi 7 L= 137.52m , B= 5m ; Aksim 8= 86.75 , B= 2 m ; Aksi 9=156 m , B=4 m

Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
------------	--------------------------	--------	-------	-----------------	-------------------------

Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Eurokodit , Kompania punë kryese është përgjegjëse për ti marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punët, në gjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore të qytetarve është e obliguar t'i kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare.

1 PUNËT PREGADITORE

1.1	Shënimi I kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet te infrastruktura rrugore sipas projektit detal , gjatë kohës sa zgjatin punimet. Llog. në m2	m2	4033.00	0.50 €	2,016.50 €
1.2	Identifikimi dhe dislokimi i instalimeve nëntoksor dhe mbitoksorë (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit), piketimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qellim të evitimin parandalimin dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit. Në këtë pozicion përfshihet edhe plani I situacionit të rrjetit ekzistues me qellim që të hartohet plani i veprimit për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues pastrimin e terenit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin dhe kubezimin e kubëzave në rruget lokale të Fshatit. Llog. m2	m2	4033.00	0.50 €	2,016.50 €
1.3	Shënimi dhe inçizimet gjeodezike në zonat dhe segmentet rrugore ku do të punohet sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet .Llog në m2	m2	4033.00	1.00 €	4,033.00 €

Gjithsej: Pos 1 8,066.00 €

2 PUNIMET TOKËSORE

Gërryerja ,gërmimi dhe largimi i dheut të kat III -V Me makina ndertimore në vendet e projektuara për nivelizimin dhe zgjerimin dhe rregullimin e rrugës lokale me trashesi t = 20 deri ne 40 cm . Në këtë pozicion përfshihet edhe nivelizimi terenit me ramjet e duhura duke përfshi edhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme , si dhe detaleve teknike . Largimi i dheut te germuar ne deponin te cilen e cakton investitori Llog m3 me të gjitha shpenzimet.

2.1	Germimi me makineri (70%)	m3	1411.00	3.00 €	4,233.00 €
2.2	Germimi me dorë (20%)	m3	402.60	4.00 €	1,610.40 €
2.3	Germimi me çekan (10%)	m3	201.60	5.00 €	1,008.00 €
2.4	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rrugessi dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes (Module dinamike me pllake rrethore) Evd=350 kg/cm ² . , para se të vendosen shtresat e tamponit .Llog me të gjitha shpenzimet	m2	4033.00	1.00 €	4,033.00 €

Gjithsej: Pos 2 10,884.40 €

3 PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)

Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së rrugës , nga materiali guror ,Fraksion (0 deri 63) mm me trashësi të shtresës $t=30$ cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes (Module dinamike me pllake rrethore) $E_{vd}=500$ kg/cm² . Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve.Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.

3.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-63 mm t=20cm	m3	1210.00	15.00 €	18,150.00 €
Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së rrugës , nga materiali guror ,Fraksion (0 deri 31.50) mm me trashësi të shtresës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibruës deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes (Module dinamike me pllake rrethore) E _v =750 kg/cm ² . Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve.Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
3.2	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm , t= 10 cm	m3	403.35	15.00 €	6,050.25 €
Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës rrafshuese me rere te imet nga gurit të thyer fraksion 0-4mm, me trashësi të shtresës t=5 cm.					
3.3	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-4 mm t= 5 cm	m3	201.70	15.00 €	3,025.50 €
Gjithsej: Pos 3					27,225.75 €
4	PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ELEMENTE BETONO-MONTUESE				
Furnizimi, transporti dhe montimi i elementeve nga betoni, llogaritur te gjitha punimet e nevojshme, nga betoni I klasit C 30/37 , d-8cm forma e gjeometris së kubëzave ,kompetenc e percaktuar nga Investitori.Në çmim të parashifet edhe Furnizimi,transporti dhe shperndarja e reres (filerit) per mbushjen e fugave ne siperfaqen e cila eshte e kubezuar. Vërejtje : Ruga e cila kubëzohet në tërësi të sipërfaqes zgjeruese prej muri në murë kur nuk ka gurë skajor përforcimi i kubëzave bëhet me beton në tërë gjatësin e rrugës të shprehur në m2 në dy anët e rrugët përgjatë perimetri të rrugës.					
4.1	Furnizimi , Transporti dhe montimi I kubëzave duke llogaritur në çmim edhe mbushjen e fugave me rërë(filer)	m2	4033.00	15.00 €	60,495.00 €
4.2	Furnizimi dhe montimi i skajoreve nga betoni C-30/37 dim.(15x24x80) cm, me baze betoni sipas detajeve ne projekt , llogaritur me te gjitha punimet e tjera te nevojshme.	m'	1705.64	15.00 €	25,584.60 €
4.4	Furnizimi, transporti ,punimii dhe nivelizimi i kokave të pusetave me shtresen finale të asfaltit,, koka përforcohen me beton arme , inkastrohet unaza metalike, si dhe vendosja e kapakut nga giza 60T i qëndrueshme ndaj komunikacioneve të rënda. Qmimi kalkulohet në Copë të rrugëve të asfaltuara , Vërejtje : Ky pozicion aplikohet kur paraqitet nevoja e ngritjes së pusetave ekzistuese në rrugë për inplementim të projektit , për shkak se pusetat po janë mbuluara me zhavorr apo asfaltë.	copë	18.00	160.00 €	2,880.00 €
Gjithsej: Pos 4					88,959.60 €

1. REKAPITULIMI - KUBËZIMI RRUGËVE NË FSHATINË GJONAJ

1	PUNËT PREGADITORE	Gjithsej: Pos 1	8,066.00 €
2	PUNIMET TOKËSORE	Gjithsej: Pos 2	10,884.40 €
3	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)	Gjithsej: Pos 3	27,225.75 €
4	PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ELEMENTE BETONO-MONTUESE	Gjithsej: Pos 4	88,959.60 €
TOTALI ME TVSH			135,135.75 €

NDËRTIMI I INFRASTUKURËS NË FSHATINË GJONAJ

1. REHABILITIMI I RRUGËS EKZISTUESE ME ASFALTË- A=11636.1 m2

Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
------------	--------------------------	--------	-------	-----------------	-------------------------

Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Eurokodit , Kompania punë kryese është përgjegjëse për ti marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punët, në gjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore të qytetarve është e obliguar t'i kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare.

1	PUNËT PREGADITORE				
1.1	Shënimi I kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet te infrastruktura rrugore sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet. Llog. në m2	m2	11636.10	0.50 €	5,818.05 €
1.2	Identifikimi dhe dislokimi i instalimeve nëntoksor dhe mbitoksorë (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit), piketimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qellim të evitimin parandalimin dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit, Në këtë pozicion përfshihet edhe plani I situacionit të rrjetit ekzistues me qellim që të hartohet plani i veprimt për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues pastrimin e terenit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin dhe kubezimin e kubezave në ruget lokale të Fshatit. Llog. m2	m2	11636.10	0.50 €	5,818.05 €
1.3	Shënimi dhe inçizimet gjeodezike në zonat dhe segmentet rrugore ku do të punohet sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet .Llog në m2	m2	11636.10	1.00 €	11,636.10 €
1.4	Prerja , grryerja dhe demolimi i asfaltit ekzistues , kubezave dhe materiale tjera të cilat pengojnë zgjerimin e rrugës materiali i demoluar largohet me ngarkim dhe transport deri në deponim më të afërt deri në 5 km largësi.	m ²	4970.0	4.00 €	19,880.00 €
Gjithsej: Pos 1					43,152.20 €

2	PUNIMET TOKËSORE				
Hapja , Gërryerja ,gërmimi dhe largimi i dheut të kat III -V Me makina ndertimore në vendet e projektuara për nivelizimin dhe zgjerimin dhe rregullimin e rrugës lokale me trashesi t = 20 deri ne 40 cm . Në këtë pozicion përfshihet edhe nivelizimi terenit me ramjet e duhura duke përfshi edhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme , si dhe detaleve teknike . Largimi i dheut te germuar ne deponin te cilen e cakton investitori Llog m3 me të gjitha shpenzimet.					
2.1	Germimi me makineri (70%)	m3	4060.00	3.00 €	12,180.00 €
2.2	Germimi me dorë (20%)	m3	1160.00	4.00 €	4,640.00 €
2.3	Germimi me çekan (10%)	m3	580.00	5.00 €	2,900.00 €
2.4	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rrugessi dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes (Module dinamike me pllake rrethore) E _{vd} =400 kg/cm ² , para se të vendosen shtresat e tamponit .Llog me të gjitha shpenzimet	m2	11636.00	0.50 €	5,818.00 €
Gjithsej: Pos 2					25,538.00 €

3	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)				
3.1	Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së rrugës , nga materiali guror ,Fraksion (0 -150) mm me trashësi të shtresës t=30 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes (Module dinamike me pllake rrethore) E _{vd} =600 kg/cm ² . Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve.Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.				

	Furnizimi dhe punimi i bazamentit me gurë gëlqerorë Fraksion 0-150 mm .Llog ne m3	m3	3490.00	12.00 €	41,880.00 €
--	--	----	---------	---------	-------------

Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së rrugës , nga materiali guror ,Fraksion (0 deri 63) mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes (Module dinamike me pllake rrethore) Evd=800 kg/cm2 . Eshte e llogaritur edhe pjesa jashta skajoreve -bankina. Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve.Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.

3.2	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-63 mm t=20cm	m3	2327.00	15.00 €	34,905.00 €
-----	---	----	---------	---------	-------------

